

## STATUTI I SHOQËRISË ME PËRGJEGJESI TE KUFIZUAR "CELA-CO" SH.P.K.

Në këtë statut

-“Ligji” është Ligji Nr. 9901,dt. 14.04.2008 “Per Tregëtarët dhe Shoqëritë tregtare”;

-“Statuti” është Statuti i shoqërise;

### Kreu I

#### Themelimi, Emri, Objekti, Kohëzgjatja, Selia

##### Neni 1:

##### Data e Themelimit, Emri dhe Themeluesit

Sot, më **05 / 02/ 2021**, une , themeluesi, kam krijuar një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar me emrin **“CELA-CO” SH.P.K.**

Themelues i shoqërisë është:

- **Mikel Cela** lindur ne Kutalli me 28.04.2001 ,shtetas shqiptar, rezident ne Berat , identifikuar me karten e identitetit me Nr. **034226573** ,madhor me zotesi te plote juridike per te vepruar.

##### Neni 2:

##### Objekti

Shoqëria do të kryej aktivitetin e mëposhtëm :

- Import – eksport,grumbullim tregtim te fruta perime, etj.
- Megjithate shoqeria ka te drejte qe te shtoje dhe te ndryshoje objektin e veprimtarise se saj me vendim te asamblese se ortakeve.

##### Neni 3:

##### Kohëzgjatja

-Kohëzgjatja e shoqërisë do të jetë 10 vjet dhe fillon qe prej dates se regjistrimit te saj ne Regjistrin e Shoqerive Tregtare ne Qendren Kombetare te Biznesit.

##### Neni 4:

##### Selia

(1)Selia e shoqërisë ndodhet në adresën:-Berat,Kutalli,fshati Samatic, rruga “Azbi Shehe” pasuri me nr.38/45, e zone kadastrale nr.3256 .

(2)Adresa e shoqërisë për qëllime komunikimi elektronik është si vijon: *cela-co@yahoo.com*

Shoqëria ka te drejte te hape dege apo filiale ne te gjithe territorin e Republikes se Shqiperise.

## **Kreu II**

### **Kapitali**

#### **Neni 5**

##### **Kapitali themeltar**

Kapitali themeltar fillestar i shoqërisë është **100 000** (njqind mije) Lekë. Pjesëmarrja e themeluesve në kapitalin e shoqërisë është në përputhje me kontributet e tyre të mëposhtme:

**1.** Ortaku themelues **Mikel Cela**: Zotërues i 1 (një) kuote me vlerë të përgjithshme prej **100 000** leke që përbën **100 %** të kapitalit themeltar të shoqërisë.

Kontributi i ortakëve do të jetë në para .

#### **Neni 6:**

##### **Zmadhimi dhe zvogëlimi i kapitalit**

Shtimi ose pakesimi i kapitalit themeltar mund te behet vetem pasi Asamblea e ortakeve me shumice e ka dekretuar kete dhe per me teper te gjithe ortaket jane te detyruar qe ta repektojne dhe te kontribuojne ne para ose ne natyre ne baze te vendimit te shumices se asmblese.

#### **Neni 7:**

##### **Transferimi i kapitalit**

Kuotat e kapitalit te një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar e te drejtat që rrjedhin prej tyre mund te fitohen apo kalohen pëpërmjet:

- a) kontributit në kapitalin e shoqërisë
- b) shitblerjes;(me te drejten e parablerjes nga ana e ortakeve).
- c) trashëgimise;
- d) dhurimit;
- e) cdo menyre tjetër të parashikuar me ligj.

Pjesët e kapitalit themeltar janë ligjerisht të trasferueshme ndërmjet ortakëve,përsa nuk parashikohet ndryshe në statur.

Pjesët e kapitalit themeltare janë ligjerisht të trasferueshme me rrugë trashgimnie.

## **Kreu II**



## ORGANET VENDIM MARRËSE DHE DREJTUESE

### Neni 8

#### Organi Vendimmarres

Asambleja e Ortakeve është organi i vetem vendimmarrës i shoqërisë.

Asambleja e Ortakeve është organi i vetem vendimmarrës i shoqërisë që miraton cdo ndryshim të statutit sipas modaliteteve të përcaktuara në ligj.

Asambleja e përgjithëshme e ortakeve është përgjegjësi për marrjen e vendimeve për shoqërinë për çështjet e mëposhtme:

- a) përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë
- b) ndryshimet e statutit;
- c) emërimin e shkarkimin e administratorëve;
- ç) emërimin e shkarkimin e likujduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar
- d) përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmëndur në shkronjat “c” dhe “ç” të kësaj pike
- dh) mbikqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshinë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- e) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- ë) zmadhimin dhe zvogelimin e kapitalit;
- f) pjestimin e kuaotave dhe anulimin e tyre;
- g) përfaqsimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- gj) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
- h) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
- i) çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti.

Ortaku mund të përfaqsohet në asamblenë e përgjithëshme, në bazë të një autorizimi nga një ortak tjetër apo nga një pëeson i tretë.

Administratori i shoqërisë nuk mund të veproj si përfaqësues i ortakëve në asamblenë e përgjithëshme.

Autorizimi mund të jepet vetem për një mbledhje të asamblesë së përgjithëshme, e cila përfshin edhe mbledhjet vijuese me të njëjtin rend dite.

## **Neni 9:**

### **Mënyra e thirrjes së mbledhjes së Asamblesë së Përgjithshme**

Asambleja e përgjithshme thirret nëpërmjet një njoftimi me shkresë ose, nëse parashikohet nga statuti, me njoftim nëpërmjet postës elektronike. Njoftimi me shkresë ose me mesazh elektronik duhet të përmbajë vendin, datën, orën e mbledhjes dhe rendin e ditës e tu dërgohet të gjithë ortakëve, jo më vonë se 7 ditë përpara datës së parashikuar për mbledhjen e asamblesë.

Kur asambleja e përgjithshme nuk është thirrur sipas pikës 1 të këtij neni, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse të gjithë ortakët janë dakort, për të marrë vendime, pavarësisht të parregullsisë.

## **Neni 10:**

### **Kuorumi**

Në astin e marrjes së vendimeve, që kërkon një shumicë të zakonshme, asambleja e përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë ortakët me të drejtë vote, që zotëojnë më shumë se 30 % të kuotave.

Në rastin kur asambleja e përgjithshme duhet të vendos për çështje, të cilat kërkojnë shumicë të kualifikuar sipas nenit 87 të ligjit "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm, nëse ortakët që zotëojnë më shumë se gjysmën e numrit total të votave, janë të pranishëm personalisht, votojnë me shkresë, apo mjete elektronike, sipas parashikimeve të pikës 3 të nenit 88 të këtij ligji.

Nëse asambleja e përgjithshme nuk mund të mbledhet për shkak të mungesës së kuorumit të përmendur më lart, asambleja mbledhet përsëri jo më vonë se 30 ditë, me të njëjtin rend dite.

## **Neni 11:**

### **Marrja e vendimeve**

Asambleja e përgjithshme vendos me tri të katërtat e votave të zotëruesve të kapitalit, të ortakëve pjesëmarrës, për ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogelimin e kapitalit të rregjistruar, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.

Asambleja e përgjithshme vendos me shumicën e votave të ortakëve pjesëmarrës, për çështje të tjera:

- a) percakimi i politikave tregtare të shoqërisë;
- b) emerimin dhe shkarkimin e administratorëve;
- c) emerimin e shkarkimin e likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël;
- ç) përcaktimin e shpërblimeve

d) mbikqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfishin përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecures së veprimtarisë;

e) përfaqsimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;

f) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;

Cdo ndryshim statuti duhet të depozitohet pranë QKR për të pasqyruar ndryshimet në skedën e shoqërisë.

#### **Neni 12:**

##### **Përfashtimi nga e drejta e votës**

1. Ortaku nuk mund të ushtrojë të drejtën e votës nëse asambleja e përgjithshme merr vendimin për :

- a) vleresimin e veprimtarisë së tij;
- b) shuarjen e ndonjë detyrimi në ngarkim të tij;
- c) ngritjen e një padije ndaj tij nga shoqëria
- ç) dhënien ose jo të përfitimeve të reja

2. Kur ortaku përfaqsohet nga një përfaqësues i autorizuar, i autorizuari vlerësohet të jetë në të njëjtin konflikt interesi, ashtu si edhe ortaku, të cilin përfaqeson.

#### **Neni 13:**

##### **Administrimi**

(1) Asambleja e përgjithshme emëron një ose më shumë persona fizikë si administrator të shoqërisë. Afati i emërimit, është **5** vjet, me të drejtë ripërtëritje. Emerimi i administratorëve prodhon efekte pas rregjistrimit në Qendrën Kombëtare të Rregjistrimit.

Administrator i shoqërisë emërohet Z. **Luli Cela** lindur ne Samatice me 02.03.1973 ,shtetas shqiptar, rezident ne Berat , identifikuar me karten e identitetit me Nr. **035836084** ,madhor me zotesi te plote juridike per te vepruar, i zgjedhur per nje periudhe **5** vjecare me te drejte rizgjedhje.

#### **Neni 14:**

##### **Kompetencat e Administratorëve**

Administratorët kanë të drejtë e detyrohen të:

- a) kryejnë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë , duke zbatuar politikat tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme;
- b) përfaqsojnë shoqërinë tregtare;
- c) kujdesen për mbajtjen e saktë dhe të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;

- ç) përgatisin dhe nënshkruajnë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, se bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, I paraqesin këto dokumente përpara asamblesë së përgjithshme për miratim;
- d) krijojnë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë mbarvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
- dh) kryen rregjistrimet dhe dërgojnë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, sic parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Rregjistrimit;
- e) raportojnë përpara asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të vacant për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;
- ë) kryejnë detyra të tjera të përcaktuara në ligj dhe në statut.
- f. Administratori do të jete personi i vetem që autorizon transaksionet bankare në llogarite të shoqërisë.

Administratorët janë të detyruar të thërrasin Asamblenë e Përgjithshme, në rastet kur:

-sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezulton ose ekziston rreziku që akivet e shoqërisë nuk e mbulojnë detyrimet e kerkueshme brenda 3 muajve në vazhdim.

-shoqëria propozon të shes apo disponojë në mënyrë tjetër aktive, të cialt kanë një vlerë më të lart se 5% të aseteve të shoqërisë që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të çertifikuara.

-shoqëria brenda 2 viteve të para pas rregjistrimit të saj, propozon të blejë nga një ortak pasuri, që kanë vlerë më të lartë se 5% të aseteve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të çertifikuara.

Nëse asambleja e përgjithshme emëron më shumë se një administrator, ata e administrojnë bashkërisht shoqërinë.

Asambleja e përgjithshme mund të shkarkojë administratorin në cdo kohë me shumicë të zakonshme. Paditë, që lidhen me shpërblimin e administratorit, në bazë të marrëdhënieve kontraktore me shoqërinë, rregullohen sipas dispozitave ligjore në fuqi.

## **Neni 15:**

### **Përgjegjësitë e Administratorit**

Administratori është përgjegjës individualisht, ndaj shoqërisë ose ndaj të tretëve, për shkelje të ligjeve, për shkelje të statutit, apo për faje të kryera gjatë administrimit të shoqërisë. Pasojat e marrëveshjeve të pamiratuara nga asambleja që i sjellin dëme shoqërisë, i ngarkohen administratorit dhe ortakut që ka bërë marrëveshjen, për të përballuar në mënyrë individuale ose solidarisht sipas rastit pasojat përkatëse.

Përveç sa është parashikuar në dispozitat e përgjithshme të detyrimit të besnikëruisë, sipas neneve 14, 15, 17 e 18 të ligjit "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", administratori detyrohet:

1.a) të kryejë detyrat e tij të përcaktuara në ligj dhe në statut në mirbesim e në interesin më të mirë të shoqërisë në tërësi duke i kushtuar vëmendje të vecantë ndikimit të veprimtarisë së shoqërisë në mjedis:

b) të ushtrojë kompetencat që i njihen në ligj dhe në statut vetëm për arritjen e qëllimeve të përcaktuara në këto dispozita;

c) të vlerësojë me përgjegjshi çështjet, për të cilat merret vendimi;

ç) të parandaloj dhe menjanojë rastet e konfliktit, present apo të mundshëm, të interesave personal me ata të shoqërisë;

d) të ushtrojë detyrat e tij me profesionalizmin dhe kujdesin e nevojshëm.

2. Administratori, gjatë kryerjes së detyrave të tij, përgjigjet ndaj shoqërisë për cdo veprim ose mosveprim, që lidhet në mënyrë të arsyeshme me qëllimet e shoqërisë tregtare, me përjashtim të rasteve kur, në bazë të hetimit dhe vlerësimit të informacioneve përkatëse, veprimi ose mosveprimi është kryer me mirëbesim.

3. Nëse administrator vepron në kundërshtim me detyrat dhe shkel standartet profesionale sipas pikave 1 e 2 të këtij neni, është i detyruar të dëmshpërblejë shoqërisë dëmet, që rrjedhin nga kryerja e shkeljes, si dhe ti kaloj cdo fitim personal që ata apo personat e lidhur me ta kanë realizuar nga këto veprime të parregullta. Administrator ka barrën e provës për të vërtetuar kryerjen e detyrave të tyre në mënyrë të rregullt e sipas standarteve të kërkuara. Kur shkelja është kryer nga më shumë se një administrator, ata përgjigjen ndaj shoqërisë në mënyrë solidare.

4. Në mënyrë të vecantë, por pa u kufizuar me to, administrator është i detyruar ti dëmshpërblejë shoqërisë dëmet e shkaktuara, nëse, në kundërshtime me dispozitat e ligjit "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", kryejnë veprimet e mëposhtme:

a) u kthen ortakeve kontributet;

b) u paguan ortakëve interest apo dividendët;

c) u shpërndan aktivet shoqërisë;

ç) lejonë që shoqëria të vazhdojë veprimtarinë tregtare, kur, në bazë të gjendjes financiare duhej të parashikohej që shoqëria nuk do të kishte aftësi paguese për të shlyer detyrimet;

d) jep kredi.

Përveç padisë për shlyerjen e dëmit që i ngarkohet personalisht administratorit, ortakët individualisht ose së bashku, kanë të drejtë të ngrenë padi penale kundër administratorit. Paditësit kanë të drejtë të ndjekin në rrugë ligjore shlyerjen e plotë të dëmit që I është shkaktuar shoqërisë, përfshirë edhe dëmshpërblimet financiare, nëse është e nevojshme. Asnjë vendim I asamblesë nuk mund të ndalojë ndritjen e kërkes padisë kundër administratorit për gabimet e kryera prej tij gjatë ushtrimit të detyrës.

#### **Kreu IV**

##### **Viti financiar-ekspertët**



## **Neni 16:**

### **Viti Financiar**

Viti financiar i shoqërisë fillon me 1 Janar dhe përfundon me 31 Dhjetor. Përbastimisht, viti i parë financiar fillon nga data e regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit dhe mbyllet më 31 Dhjetor.

## **Neni 17:**

### **Ekspertët**

Eksperti ka për detyrë që të kontrollojë të gjithë dokumentacionin kontabel të veprimtarisë ekonomiko tregtare të shoqërisë, atë gjithëvjetor dhe atë në lidhje me kontrollet periodike të ushtruara prej tij për rastet kur ai është ngarkuar dhe ka kryer një gjë të tillë i ngarkuar nga ana e ortakëve.

Në përfundim të kontrollit eksperti kontabel i autorizuar përgatit raportin me shkrim për nxierien e rezultatit të bilancit financiar vjetor si dhe për atë për kontrollet periodike të ushtruara, të cialt është i detyruar që tja paraqesë e ta dorëzojë në kohë ortakëve për ti shqyrtuar e miratuar mbi bazën e të drejtës vendimore që ka.

## **Kreu V**

### **Prishja-riorganizimi i shoqërisë**

## **Neni 18:**

### **Prishja dhe likuidimi**

Shpërndarja ose prishja e shoqërisë mund të bëhet në cdo kohë:

- a) kur mbaronë kohëzgjatja e parashikuar në themelimin e saj;
- b) me vendim të Asambles së Ortakëve;
- c) me hapjen e procedurave të falimentimit;
- ç) nëse ka kryer veprimtari tregtare për 2 vjet dhe nuk është njoftuar pezullimi i veprimtarisë në përputhje me pikën 3 të nenit 43 të ligjit nr. 9723, datë 03.05.2007 "Për Qendrën Tregtare të Regjistrimit";
- d) me vendim të gjykatës;

Në këtë rast marrin vendim me shkrim në të cilin parashikojnë menyrën e likuidimit të shoqërisë, duke caktuar një apo disa likuidatorë dhe shënuar në cdo document të nxier prej tij emrin e likuidatorit dhe emërtesën shtesë "Shoqërinë në likuidim e sipër".

Prishja e shoqërive tregtare ka si pasojë hapjen e procedurave të likuidimit në gjendjen e aftësisë paguese, me përjashtim të rastëve kur është nisur një procedurë falimentimi.



Likujdimi kryhet nga likujduesi e emëruar nga Ortakët.

Nëse ortakët nuk marrin një vendim për emerimin e likujduesve, brenda 30 ditëve pas prishjes, cdo person i interesuar mund ti drejtohet gjykatës, për të caktuar një likujdues.

**Neni 19:**

#### **Riorganizimi i shoqërisë bashkimi-ndarja**

Shoqëria mund të ndahet, bashkohet sipas Vendimit të Mbledhjes së Përgjithshme të Asamblesë së Ortakëve, në përputhje me dispozitat ligjore të parashikuara në Pjesën IX të Ligjit 9901 datë 14.04.2012 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”.

**Neni 20:**

#### **Baza Ligjore**

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e tij në përputhje të plotë me këtë statut dispozitat e legjislacionit shqipëtarë.

Për sa nuk parashikohet në këtë statut do të zbatohen dispozitat e ligjit “Per tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, Kodi Civil dhe çfarëdo ligji tjetër specifik në Republikën e Shqipërisë.

**Neni 21:**

#### **Mosmarrëveshjet**

Për mosmarrëveshjet që mund të lindin në lidhje me zbatimin apo interpretimin e këtij statute, si dhe për cdo mosmarrëveshje që mund të lind midis Shoqërisë dhe të tretëve, do të jetë kompetente Gjykata Shqipëtare.

### **ORTAKU I VETEM I SHOQERISE**

**Mikel Cela**